REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 305 Prot. Maliq,më 22.01.2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 10 ,datë 22.01.2026

"Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2027-2029"

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015. "*Për vetëqeverisjen vendore*",neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" pika c,si dhe neni 54 "*Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak*" pika dh Ligjin nr.68 "*Për financat e vetë qeverisjes vendore",Kreu VII "Përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit*" neni 34 "*Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve*",pika 1, Ligjit nr.9632,datë 30.10.2006 "*Për sistemin e Taksave Vendore* " propozoj miratimin e këtij projekt-vendimi nga këshilli duke vendosur:

1. Të miratojë projekt buxhetin afatmesëm të të ardhurave për periudhën 2027-2029.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@bashkiamaliq.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr.305 Prot. **Maliq,më 22/01/2026**

Lënda: **Parashikimet afatmesme të të Ardhurave për periudhën 2027-2029.**

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Mbështetur në Ligjin nr.68 "*Për financat e vetë qeverisjes vendore*",neni 34 "*Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve*",pika 1 po paraqesim për miratim raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

a.dy vitet para vitit buxhetor
b.vitin buxhetor
c.tre vitet e ardhshme buxhetore
Këto të dhëna pasqyrohen në tabelën e mëposhtme: (000/lekë)

Nr	Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakt		Parashikimi			
		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
I	**Të ardhura nga taksat**	**96 251**	**100 813**	**133 422**	**133 422**	**133 422**	**133 422**
1	Tatim I thjeshtuar fitimi	331	166	350	350	350	350
2	Taksa mbi ndërtesat	13 873	13 450	22 339	22 339	22 339	22 339
3	Taksa mbi truallin	3 230	2 341	2 748	2 748	2 748	2 748
4	Taksa mbi tokën bujqësore	27 386	23 313	47 296	47 296	47 296	47 296
5	Taksa e fjetjes në hotel	0	0	0	0	0	0
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturënga ndërtimet e reja dhe nga legalizimet	9 011	14 159	15 000	15 000	15 000	15 000
7	Renta minerale	307	241	250	250	250	250
8	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	4	1 050	30	30	30	30
	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	18 448	20 839	19 800	19 800	19 800	19 800

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@bashkiamaliq.gov.al

10	Taksa e regjistrimit të përvitshëm biznesi	0	0	0	0	0	0
11	Taksa e tabelës/reklamë	762	1 260	3 609	3 609	3 609	3 609
12	Taksa të përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	800	400	1 000	1 000	1 000	1 000
13	Taksë tavoline	0					
14	Tatim mbi TAP	18 499	16 334	19 000	19 000	19 000	19 000
15	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	3 600	7 260	2 000	2 000	2 000	2 000
II	**Të ardhura nga tarifat**	**51 352**	**50 030**	**116 855**	**116 855**	**116 855**	**116 855**
1	Tarifë pastrimi	27 169	28 415	59 693	59 693	59 693	59 693
2	Tarifë për hapsira publike(servitut+kantina+treg u I lirë+mall I dyqanit)	338	342	340	340	340	340
3	Tarifë për ndiçim rrugor	8 642	8 397	22 377	22 377	22 377	22 377
4	Tarifë mirëmbajtje varrezash	3 725	3 297	8 374	8 374	8 374	8 374
5	Tarifë gjelbërimi	2 307	2 330	4 160	4 160	4 160	4 160
6	Taksa për zënien e hapsirave publike	108	74	152	152	152	152
7	Tarifë parkimi	647	630	780	780	780	780
8	Tarifë për shërbime të tjera administrative	1 656	1 498	2 251	2 251	2 251	2 251
9	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	373	296	282	282	282	282
10	Tarifë uji ujitje	2 258	870	11 310	11 310	11 310	11 310
11	Tarifë lejë nonstop	30	0				
12	Tarifë për mjete korrëse	130	105	130	130	130	130
13	Tarifë për mirëmbajtje kanale kulluese	2 288	1 972	4 745	4 745	4 745	4 745
14	Kazan rakije	10	0				
15	Tarifë ndikimi në mjedis	1 580	1 686	1 261	1 261	1 261	1 261
16	Tarifë për mbrojtje nga zjarri	91	118	1 000	1 000	1 000	1 000
III	**Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qira**	**11 665**	**12 906**	**8 269**	**8 269**	**8 269**	**8 269**
1	Qira objekti+qira trualli+qira toka bujqësore+qira kullota	11 665	12 906	8 269	8 269	8 269	8 269
IV	**Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme**	**0**		**0**	**0**	**0**	**0**
V	**Të ardhura të tjera**	**11 673**	**17 166**	**61 480**	**61 480**	**61 480**	**61 480**
1	Transferta e pakushtëzuar	0		0	0	0	0
2	Tarifë për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)	0		0	0	0	0
3	Sporte dhe kultura	135	115	210	210	210	210
4	Dhurata dhe sponsorizime të ndryshme	9 569	1 715	0	0	0	0
5	Të ardhura nga gjobat	744	751	1 270	1 270	1 270	1 270
6	Çertefikatë për mbrojtjen nga zjarri	0		0	0	0	0

7	Miratim projekti	0		0	0	0	0
8	Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara	0		0	0	0	0
9	Shërbime zjarrfikëse në bashkitë fqinje	0		0	0	0	0
10	Marrje me qira pylli	0		0	0	0	0
11	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit+heqje materiali drusor	3		60 000	60 000	60 000	60 000
12	Vërtetime transporti	0		0	0	0	0
13	Prodhimet e dyta medicinale	0		0	0	0	0
14	Të ardhura të trashëguara nga viti I kaluar	0		0	0	0	0
15	Të tjera (enti+banesa soc+kamata)	0		0	0	0	0
16	Ekspert shpenzime gjyqësore	0		0	0	0	0
17	Grante	473	14 585	0	0	0	0
18	Divident nga ndarja e sektorit publik	485		0	0	0	0
19	Shitje skrapi	264		0	0	0	0
VI	**Totalii të ardhurave të veta (I+II+III+IV+V)**	**170 904**	**180 915**	**320 026**	**320 026**	**320 026**	**320 026**
VII	**Të ardhura të kushtëzuara**						
	Transferta të kushtëzuara						
	Fondi I Zhvillimit të rajoneve						
	Transferta specifike						
VIII	**Të ardhurat gjithësej (VI+VII)**	**170 941**	**180 915**	**320 026**	**320 026**	**320 026**	**320 026**

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e të ardhurave për vitet 2027-2029 është:

1. Në përllogaritjen e tarifës së pastrimit,ndriçimit dhe gjelbërimit për familjarët ,është marrë për bazë numri i familjeve sipas gjendjes civile(janë bërë veprimet duke hequr familjet migrante dhe familjet në zonat e përjashtuara nga tarifat).
2. Në planifikimin e zërit taksë toke janë marrë për bazë të dhënat që rezultojnë nga regjistri 6 i tokës bujqësore, sipas kategorve përkatëse të tokës. Në planifikim janë përfshirë detyrimet e të gjitha familjeve pa marrë parasysh nëse janë rezidente ose jo.
3. Në planifikimin e zërit taksë ndërtese janë marrë për bazë të dhënat që disponojmë në bazë të regjistrit 1 si dhe përditsimet që janë bërë nga sistemi i Kadastrës Fiskale si dhe matjet e kryera nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Në planifikim janë përfshirë detyrimet e të gjitha familjeve pa marrë parasysh nëse janë rezidente ose jo.
4. Në planifikimin e zërave Rentë Minerare,Të ardhura nga DRTRRSH,Tatim mbi të ardhurat Personale,Të ardhura nga ASHK janë marrë parasysh të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025.

5. Në llogaritjen e të ardhurave nga mjetet e transportit janë marrë për bazë të dhënat që disponojmë për numrin e mjeteve të licensuara të cilat aktualisht ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Maliq.
6. Në përllogaritjen e të ardhurave nga biznesi, janë marrë për bazë të dhënat e marra nga DRT Korçë. Nga ana jonë për çdo subjekt është përcaktuar qartë xhiroja vjetore, sipas të cilës bëhet klasifikimi i bizneseve për pagesën e tarifave vendore.

Buxheti i parashikuar nga ana jonë është ambicioz dhe me risk të lartë. Synimi ynë ka qënë që ky buxhet të jetë sa më real dhe objektiv. Realizimi i të ardhurave është detyra jonë primare.

Risku më i madh në realizimin e të ardhurave të parashikuara është:

a) Mbledhja e debisë së akumuluar

Një pjesë e mirë e personave që kanë vlerë debitore kanë aftësi të ulët paguese.

b) Mbledhja e taksave dhe detyrimeve për familjet e emigrantëve dhe personave që disponojnë pasuri por aktualisht nuk jetojnë në to.

Një veçori e Bashkisë Maliq është numri i madh i familjeve emigrante ,duke rritur riskun për mbledhjen e detyrimeve të tyre.

c) Parashikimi në buxhet i zërit të ardhura nga drutë e zjarrit,realizimi i të cilit është tepër i vështirë për arsye objektive që nuk varen nga ne.
d) Realizimi i të ardhurave nga zëri ujitje paraqet vështirësi sepse shërbimi ofrohet nga ana e Bashkisë Maliq,por qytetarët shfrytëzojnë gjatësinë e kanaleve për ujitje duke përdorur pompa të ndryshme duke vështirësuar mbledhjen e të ardhurave nga ky zë.

Përgjegjës Sektori i të Ardhurave

Alma SHKËLQIMI

Drejtor Drejtoria e të Ardhurave

Jona GRABOCKA

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ